

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.02.2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtorëve të Drejtorive të Urbanizmit të Komunave
CC:	z.Ferid AGANI, Ministër i MMPH-së Kryetareve të Komunave të Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shtyerjen e afatit për regjistrimin e ndërtimeve pa leje

Të nderuar,

Sipas nenit 5 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 04/L-188 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, procesi i regjistrimit të ndërtimeve pa leje përfundon më datën 05.02.2015.

Procesi i Regjistrimit të Ndërtimeve pa leje ka filluar në të njëjtën kohë dhe me procedura të unifikuara në tërë territorin e vendit tonë. Procesi ka rezultuar me një bashkëpunim të shkëlqyeshëm në mes të Ministrisë dhe të gjitha komunave.

I falënderojmë të gjitha ato komuna që me punën e tyre të palodhshme kanë regjistruar me mijëra ndërtime pa leje. Njëkohësisht, duke u bazuar në dinamikën e regjistrimit dhe sipas kërkesave të shumicës së komunave, ky proces duket se nuk mund të përfundojë më datën e caktuar me ligj. Shtojmë këtu edhe mos fillimin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në disa komuna, si rrjedhojë mund të konkludohet se afati për regjistrimin e ndërtimeve pa leje kërkon edhe një kohë shtesë për përfundimin e tij.

Arsyet kryesore për shtyrjen e afatit për regjistrimin e ndërtimeve pa leje, të identifikuar nga Ministria pas kontakteve të vazhdueshme me komunat, janë:


- Procesi i regjistrimit të Ndërtimeve pa leje ka filluar vonë por ka filluar me një entuziazëm të madh nga vetë komunat si dhe nga qytetarët, andaj është shumë me rëndësi që vazhdimi i regjistrimit të ndërtimeve të bëhet pa e ndërprerë kontinuitetin e këtij procesi.
- Sipas informatave nga komunat, për t'i regjistruar të gjitha ndërtimet pa leje në territorin e tyre, komunave ju nevojitet kohë shtesë meqenëse ka interesim të madh të qytetarët dhe koha për regjistrim deri më 5 shkurt 2015 nuk është e mjaftueshme.
- Si rezultat i kampanjës publike të organizuar nga Ministria dhe komunat, opinioni publik është sensibilizuar dhe qytetarët masovikisht i janë përgjigjur procesit të regjistrimit. Sipas të dhënave nga Ministria, gjer më tani janë regjistruar më shumë se 95000 ndërtime pa leje.

Duke e marrë parasysh situatën në të cilën jemi dhe duke u bazuar në Ligjin për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, Ministria i jep instruksionet si në vijim:

1. Nga 5 shkurti deri më 11 qershor, komunat mund të vazhdojnë të pranojnë kërkesat për tu listuar në Regjistër (shtojca 1).
2. Komunat duhet të informojnë qytetarët/aplikuesit që kërkesa e tyre do të konsiderohet si "ankesë" sipas Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, neni 4 paragrafi 4 (shtojca 2).
3. Njoftojmë komunat se sipas nenit 5 paragrafit 2 të Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, Komunat janë përgjegjëse për të kompletuar listën me të gjitha ndërtimet pa leje që janë të mbuluara me këtë Ligj, për ndërtimet e përfunduara apo të filluara para datës 30 gusht 2013. Gjatë kësaj kohe ju gjithashtu duhet të përfundoni punën në identifikimin e të gjitha ndërtimeve pa leje në tërë territorin e Komunës tuaj.
4. Gjithashtu, njoftojmë komunat se brenda disa javëve Ministria do të nxjerr Udhëzimin Administrativ për procedurat e ankesave ku do të përfshihen dhe qartësohen të gjitha hapat e proceduarve të ankesës.

Me shume hollësi te shpjegimit Ligjor mund të gjeni ne shtojcën 3.

Me respekt,



Kërkesat për Regjistrim do të pranohen deri më 11 qershor 2015